



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 55, datë 28.02.2023

PËR

MIRATIMIN E NJË SHTESE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 118, DATË 27.10.2022 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.5, RRUGA “DAVID SELENICA”, PALLATI NR. 18, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.164, datë 19.2.2020, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, i ndryshuar; Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr.104, datë 08.07.2022; Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit”, i ndryshuar; Raportit me nr. 1789/1 prot. datë 20.02.2023 të Komisionit të Posaçëm miratuar nga kryetari i bashkisë, si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e një shtese në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 118, datë 27.10.2022, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative nr.5, rruga "David Selenica", pallati nr. 18, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, si më poshtë vijon:

2. Pas pikës 1 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 118, datë 27.10.2022, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative nr.5, rruga "David Selenica", pallati nr. 18, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, shtohet pika 1.1, si më poshtë vijon:
 - 1.1. Subjektet përfituese të pallatit nr. 18, në Njësinë Administrative nr.5, rruga “David Selenica” do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit të Zonës së Re për Zhvillim nr. 4, Njësia Administrative Durrës, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 164, datë 19.2.2020, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, i ndryshuar.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 02.03.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 166 prot.
11

Durrës, më 13 03 .2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.55 datë 28.02.2023 “Për miratimin e një shtese në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 118, datë 27.10.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në njësinë administrative nr.5, rruga “david selenica”, pallati nr. 18, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

